

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË PARAQITJEN E PROGRAMIT MASTER
NË KRIMINOLOGJI**
14 dhjetor 2020

Zonja ministre, i nderuar rektor, të nderuar dekanë dhe pjesëmarrës,

Edhe pse në kohë të vështira, vërej me kënaqësi bashkëpunimin e fortë me Prezencën e OSBE-së, siç tregohet edhe sot me paraqitjen e programit të parë master në kriminologji.

Ka disa arsye se përse e gjykoj si shumë të rëndësishëm këtë zhvillim. Së pari, dëshiroj të shpreh respektin e madh që kam për botën akademike. Me anë të mësimdhënies, profesorët e kanë kthyer jetën e tyre në akt dashurie ndaj vendit, duke investuar në të paktën dy pasuri themelore të çdo shoqërie: tek arsimit dhe te rinia. Universiteti i Tiranës është djep kulture, është vatër e mrekullueshme e qytetarisë së pjekur, mjedis ku të rinjtë mund të bëhen anëtarë të përgjegjshëm dhe veprues të komunitetit, ku qytetarët mund të zgjerojnë njohuritë dhe t'ua kalojnë ato të tjerëve.

Në të njëjtën frymë, dëshiroj të falënderoj ministren e Arsimit të Shqipërisë, znj. Evis Kushi, për praninë e saj këtu, si dëshmi e përparësisë me të cilën autoritetet shtetërore shohin arsimin, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe, sigurisht, luftimin më me efektshmëri të krimit, çka përbën edhe qëllimin e këtij programi master.

Më lejoni të shtoj se ndihem krenar që ndodhem sot këtu në emër të OSBE-së, kësaj organizate të mrekullueshme. E çmoj faktin që po ndihmojmë përpjekjet e Universitetit të Tiranës në kuadër të arsimit, së bashku me qeverinë e SHBA-së dhe atë të Britanisë.

Për t'iu kthyer qëllimit të këtij kursi, me lejoni të theksoj disa pika. Krimi është padyshim fenomen social i ndërlikuar. Lufta ndaj tij mund të përmirësohet ndjeshëm me anë të masave përkatëse që bazohen në studime shkencore: masa si parandalimi, hetimi, ndjekja penale, trajtimi dhe riintegrimi i autorëve të veprave penale, mbrojtja e viktimave dhe e shoqërisë.

Është e qartë se kërkon përjasje të bashkërenduar dhe, për këtë arsye, jam i lumtur të theksoj se kur OSBE-ja bashkon energjitë e saj me Fakultetin e Drejtësisë dhe me Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, mund të ketë vetëm rezultate të dukshme në të mirë të të gjithë shoqërisë.

Sot, ne po korrim frytet e më shumë se dy viteve pune me intensitet. Përgjatë kësaj kohe, u zhvillua struktura dhe kurrikula e programit master, si dhe u ngritën kapacitetet dhe burimet e Universitetit të Tiranës me qëllim ofrimin dhe administrimin e programit.

Ky master ekzekutiv në kriminologji, i pari i llojit të tij në Shqipëri, ka potencialin të çojë përpara disiplinën në fjalë, duke u shkëputur nga përqsja klasike ndaj krimit, e cila bazohet te hetimi dhe ndëshkimi, e duke e kaluar vëmendjen dhe përpjekjet drejt një përqsjeje më gjithëpërfshirëse. Sipas të gjitha gjasave, një numër gjithnjë e në rritje i profesionistëve ligjzbatues shqiptarë do të përmirësojnë aftësitë dhe kapacitetet e tyre për përdorimin e të dhënave empirike me qëllim luftimin e efektshëm të krimit, sipas një metode moderne të bazuar në studime shkencore. Kemi besim se ky program do të arrijë t'u ofrojë mjete atyre që përkrahin trajtimin me qëndërzim komunitar të autorëve të rehabilituar të veprave penale, çka do të çojë në zvogëlimin e përjashtimit shoqëror dhe në përkrahjen e përfshirjes.

Në të njëjtën kohë, nuk duhet të harrojmë se sa i rëndësishëm është mobilizimi dhe rritja e aftësive të shoqërisë civile dhe i komunitetit në tërësi për të marrë përgjegjësi për krimin dhe çrregullimet shoqërore dhe për të zhvilluar reagime pozitive dhe kolektive ndaj problemeve me të cilët hasen komunitetet dhe individët.

Ka në fakt prova të qarta që dëshmojnë se strategjitë e mirëplanifikuara për parandalimin e krimit, jo vetëm që parandalojnë krimin dhe viktimizimin, por edhe përkrahin sigurinë e komunitetit dhe ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve.

Dëshiroj ta përdor këtë mundësi për të falënderuar edhe njëherë Misionin e SHBA-së në OSBE dhe ambasadën britanike në Tiranë për financimin e këtij projekti novator dhe të vlerësoj interesin dhe përfshirjen e të gjithë partnerëve të projektit.

Pres me padurim të shoh rezultatet e programit masterit dhe u uroj të gjithë partnerëve bashkëpunim të frytshëm në të mirë të shoqërisë shqiptare.

Ju falënderoj shumë dhe u uroj sukses të gjithë atyre që do të zbatojnë programin master dhe, veçanërisht, të gjithë studentëve të tij të ardhshëm.

Fund